

VENDIM
Nr. 684, datë 28.9.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM ASFALTIM RRUGË E SHESHE, BLOQET E BANIMIT
SHEJA, TREGU I QYTETIT, SHKUMBINI DHE USHTARAKU”, LIBRAZHD**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim asfaltim rrugë e sheshe, bloqet e banimit Sheja, tregu i qytetit, Shkumbini dhe Ushtaraku”, Librazhd.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Librazhd.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme 370 690 (treqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 370 690 (treqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Librazhd.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Librazhd.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Librazhd, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Librazhd dhe Bashkia Librazhd për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

BASHKIA LIBRAZHD

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT

“SISTEMIM ASFALTIM RRUGË E SHESHE, BLOQET E BANIMIT SHEJA, TREGU I QYTETIT, SHKUMBINI DHE USHTARAKU”, LIBRAZHD

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe truall m ²	Çmimi i truallit leke/m ²	Vlera e truallit	Vlera e objektit lekë	Vlera totale e shpronësimit lekë	Shënime
1	Tahir Destan Bahiti	2446	10/209	Truall	48	2,898	139,104	231,586	370,690	Konfirmuar nga ZVRPP-ja